

LIGJ
Nr.7699, datë 21.4.1993

PËR KOMPENSIMIN NË VLERË TË ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj u njeh të drejtën e pronësisë për efekt kompensimi në vlerë të tokës bujqësore ish-pronarëve, personave fizikë e juridikë, që e kanë pasur atë në pronësi në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945 "Për reformën agrare".

KREU II
PËRCAKTIME

Neni 2

Në këtë ligj do të përdoren këto përcaktime:

"Tokë bujqësore" - janë të gjitha tokat e përcaktuara në Shqipëri si toka bujqësore, duke përfshirë ullinjë, pemëtoret, vreshtat dhe tokat që konsideroheshin të tilla në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945. Përfshihen tokat që për efekt kompensimi do të trajtohen nga ligje të tjera.

"Ish-pronarë toke bujqësore" - janë personat ose trashëgimtarët e tyre, të cilët gëzonin pronësinë mbi tokën bujqësore në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945.

"Trashëgimtarë" - pasardhës që sipas ligjit kanë të drejtën e trashëgimit të pasurisë.

"Tokë e regjistruar" - tokë që është regjistruar në zyrën e kadastrës, hipotekës ose në ndonjë regjistrë tjetër të njohur me ligj, në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945.

"Obligacion" - instrument financiar që do të përdoret për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokave bujqësore.

KREU III
E DREJTA E KOMPENSIMIT

Neni 3

E drejta e kompensimit në vlerë të tokës bujqësore u njehet personave që kanë qënë pronarë të tokave bujqësore sipas përcaktimit në nenin 1 të këtij ligji dhe personave të njohur si trashëgimtarë ligjorë të tyre, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Neni 4

E drejta e kompensimit në vlerë të tokës bujqësore u njehet ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre, prona e të cilëve figuron e regjistruar, ose në mungesë të tyre, kur pronësia vërtetohet me vendim të gjykatës së rrethit përkatës.

Neni 5

Të gjitha pretendimet për kompensim në vlerë, në rastet kur janë kryer kalime të pronësisë së tokës bujqësore pas vitit 1945 nga pronarët privatë të cilët nuk janë regjistruar në kadastër, do zgjidhen me marrëveshje ndërmjet palëve dhe, kur është e pamundur me vendim të gjykatës së rrethit.

Neni 6

1. Ish-pronari ose trashëgimtarët e tij që kanë marrë tokë bujqësore sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, përfitojnë kompensim në vlerë për diferencën ndërmjet sipërfaqes së tokës bujqësore që kanë pasur dhe asaj që kanë marrë, pasi të jenë pajisur ligjërisht me aktin e marrjes në dorëzim të tokës bujqësore.

2. Për ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre që nuk përfitojnë tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, kompensimi në vlerë i tokës bujqësore që kanë pasur bëhet sipas neneve 4 e 8 të këtij ligji.

3. Shuma e tokës së përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, dhe e sipërfaqes që do t'i kompensohet ish-pronarit ose trashëgimtarëve të tij, në asnjë rast nuk duhet të kalojë sasinë e tokës bujqësore të njohur për kompensim sipas neneve 4 e 8 të këtij ligji.

Neni 7

Pemëtoret e vreshtat, tokat e të cilave nuk janë regjistruar si tokë bujqësore, por që konsiderohen si të tilla për qëllimet e këtij ligji, pas verifikimit në kadastër, konvertohen në të tilla mbi bazën e koeficientëve të konvertimit që do të miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Ullishtet do të vlerësohen për efekt kompensimi me numër rrënjësh.

Neni 8

1. Ish-pronarët e tokës bujqësore, sipas dispozitave të këtij ligji, përfitojnë kompensim të plotë në vlerë për sipërfaqen deri në 15 ha.

2. Për ish-pronarët që kanë pasur në pronësi mbi 15 ha tokë bujqësore, kompensimi në vlerë për pjesën tjetër të tokës bujqësore bëhet sipas formulës:

a) Nga 15 ha deri në 100 ha tokë bujqësore, çdo hektar mbi 15 ha kompensohet me vlerën e 0,1 ha.

b) Nga 100 ha deri në 1100 ha tokë bujqësore, çdo hektar mbi 100 ha kompensohet me vlerën e 0,02 ha.

c) Për pjesën e sipërfaqes mbi 1100 ha nuk do të ketë kompensim në vlerë shtese.

3. Në asnjë rast shuma maksimale e kompensimit në vlerë nuk duhet të jetë më e madhe se ekuivalenti i një sipërfaqeje prej 43.5 ha.

Pavarësisht nga numri i trashëgimtarëve të pronarit, sipërfaqja totale e tokës që atyre u kompensohet në vlerë, do të jetë sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 9

Masa në vlerë e kompensimit që do të jepet për ha tokë bujqësore, përcaktohet me ligj brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi këtij ligji.

Neni 10

1. Kompensimi në vlerë do të jepet në përputhje me nenin 8 vetëm nëpërmjet obligacioneve shtetërore të emetuara në lekë.

2. Këto obligacione do të jenë lirisht të transferueshme dhe mund t'u shiten personave të tretë, sipas çmimit të vendosur lirisht ndërmjet palëve.

3. Obligacionet shtetërore do të jenë tituj të garantuar dhe kanë të drejtën e parablerjes në blerjen e pronës shtetërore si, objekte industriale, troje ndërtimi, tokë e aksione të ndërmarrjeve

shtetërore.

4. Shteti është i detyruar t'i shlyejë këto obligacione përmes pasurisë shtetërore deri më 31.12.1999. Pas këtij afati, për një periudhë 5-vjeçare, shlyerja mund të bëhet edhe me lekë.

Neni 11

Nuk trajtohen në këtë ligj pronat e ish-mbretit dhe shoqërive të huaja ose të përbashkëta.

Neni 12

Nuk përfitojnë nga ky ligj:

- Ish-bashkëpunëtorët e okupatorëve nazifashistë për pronat e vëna gjatë okupacionit, pas rishikimit të proceseve ose përcaktimit të tyre si të tillë prej Gjykatës së Kasacionit.
- Ish-drejtuesit e partisë dhe pushtetit komunist për pronat e vëna si pasojë e shpërdorimit të postit zyrtar të vërtetuar me vendim gjyqi.
- Të dënuarit për përvetësim të pasurisë së popullit në përpjestime të mëdha, në masën që është e barabartë me vlerën e dëmit të përcaktuar me vendimin e gjykatës.

KREU IV PROCEDURA E KOMPENSIMIT

Neni 13

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet komiteti shtetëror i kthimit ose kompensimit në vlerë të pronave.

Të drejtat e detyrat e këtij komiteti caktohen me akte nënligjore nga Këshilli i Ministrave.

Neni 14

Ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre duhet të paraqesin në degët e komitetit shtetëror të kompensimit të pronave në rreth dokumentet e pronësisë brenda 1 viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Me kalimin e këtij afati dokumentet nuk pranohen dhe ish-pronarët ose trashëgimtarët e tokave bujqësore nuk kanë të drejtë të kërkojnë kompensim.

Neni 15

Kundër vendimit të komitetit shtetëror mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit brenda 10 ditëve nga data e komunikimit të tij; në të kundërt vendimi i komitetit shtetëror është i formës së prerë.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.525, datë 23.4.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.